



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:033569

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06789476

P.nr.79/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale, kundër të pandehurit V.M, nga fshati, Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale “*Shpërdorimi i pasurisë së huaj*” nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.89/2024 të datës 26.01.2024, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 14.01.2025, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit V.M, me datë 17.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

V.M, i lindur me datë, në Pejë, me vendbanim në fshatin, Komuna e Pejës, i biri i A. dhe nënës A2., e vajzërisë, me profesion, i pa martuar, me gjendje te mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, posedues i nr. të tel., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- I. *Më datë 10.01.2024 rreth orës 12:14 në Pejë, në rr.”, pikërisht në marketin “.....” K-Pejë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, tjetrit i’a merr pasurinë luajtshme dhe atë të dëmtuarës R.B, në atë mënyrë që, i pandehuri hynë në marketin e lartcekur dhe fillimisht e shpërqendron punëtoren e marketit duke i kërkuar diçka tjetër, në momentin që punëtorja largohet i njëjti shfrytëzon rastin dhe tek arka e marketit merr një shishe të alkoolit “Jegermaister” dhe largohet nga aty.*

-Me këtë ka kryer veprën penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

- II. Me datën 06.01.2024 rreth orës 18:00 në Rr. “.....”, Pejë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personit tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar atij, dhe atë të dëmtuarës G.J.S në atë mënyrë që, i pandehuri deri sa ishte duke qëndruar në banesën e të dëmtuarës, fillimisht e merr nga e dëmtuara telefonin e markës Samsung A7 për tu shërbyer me të, e më pas largohet nga banesa, ku me vete e merr edhe telefonin e të dëmtuarës, të cilin më pas e shet në vlerë prej 40 euro,

-Me këtë ka kryer veprën penale “*Shpërdorimi i pasurisë së huaj*” nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 76, 79 si dhe nenit 313 par.1 dhe neni 333 par.2 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 364, 449, 450, 452 të KPPRK-së, të akuzuarit V.M, fillimisht i:

I PËRCAKTON

-Për veprën penale “*Vjedhje*” nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, nga pika I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

-Për veprën penale “*Shpërdorimi i pasurisë së huaj*” nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së, nga pika II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh si dhe dënimin më gjobë në shumën prej katërqind (400) euro.

Në kuptim të nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.5 të KPRK-së, gjykata të pandehurit V.M, i shqipton dënim të unifikuar si në vijim:

GJYKON

- I. Të pandehurin V.M, me **DËNIM UNIK ME BURIGIM**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor prej dyzetetë (48) orësh, nga data 10.01.2024 deri më datën 12.01.2024, e i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Si dhe **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej katërqind (400) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguajë, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t’ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20)

euro gjobë. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.

- IV.** Obligohen të pandehurit secili veç e veç që gjykatës të ia paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.
- V.** Të dëmtuarat R.B dhe G.J.S nga Peja, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 26.01.2024 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.89/2024 kundër të pandehurit V.M, nga fshati, Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale “*Shpërdorimi i pasurisë së huaj*” nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 14.01.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit V.M.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohej mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprat penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe “*Shpërdorimi i pasurisë së huaj*” nga neni 318 paragrafi 1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim dhe se i njëjti është i penduar, i vie keq për atë se çfarë ka ndodhur.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç’rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Shkresat e Kallëzimit Penal me nr.2024-DA-38, Raporti i Oficerit, H.Z #11402, e dt.10.01.2024, Raporti Informues, D.G #10490, Procesverbali i marrjes në pyetje dëshmitarin R.B, me dt. 10.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin V.M, me dt. 10.01.2024,1 (Një) CD, Shkresat e Kallëzimit Penal me nr. 2024-DA-41, Raporti i Oficerit, A.L #11958, i dt.11.01.2024, Raporti Informues, E.S #2788, i dt.11.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin G.J.S, e dt.11.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje dëshmitarin S.A, e dt. 11.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin V.M, me dt. 12.01.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje dëshmitarin A.B, e dt.13.01.2024*, ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar së: *siç edhe e theksova me lartë, në rastin e matjes se dënimit i propozoj gjykatës që si rrethanë rënduese të marrë parasysh dënimet e mëparshme të të pandehurit ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj ka deklaruar: *sa i përket rrethanave rënduese i propozoj gjykatës të marr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndërkaq si rrethanë lehtësues pranimin e fajësisë.*

I pandehuri V.M ka deklaruar: *jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, të dëmtuarës i kam kërkuar falje, i premtoj gjykatës që ne te ardhmen nuk do të kryej vepra penale, me vjen shumë keq për këtë se çfarë ka ndodhur, shpreh keqardhje.*

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryej në mënyrë të përshtetur si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, ndërkaq si rrethana rënduese gjykata mori faktin se i njëjti është i dënuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.858/13, të dt.21.08.2017, i cili është bërë i plotfuqishëm me datës 27.04.2020, i akuzuar për shkak të veprës penale “*Vjedhje*” nga neni 252 par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPRK-së, të cilit i është shqiptuar dënimi më gjorbë në shumën prej 400 euro, po ashtu edhe sipas P.nr.396/22, të dt.25.01.2024, i cili është bërë i plotfuqishëm me datës 13.11.2024, për shkak të veprës penale “*Mashtrim*” nga neni 323 par.1

të KPRK-së, me dënim me gjobë në lartësi prej treqind (300) Euro si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, të cilat dënime kushtëzohen, nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen veprën tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) viteve, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe nën këto rrethana gjykata vlerëson që si rrjedhojë vërehet se nuk është arritur qëllimi i dënimit sa i përket rehabilitimin e tij.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të tij e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 42 par.1 dhe nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së, si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 dhe neni 318 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, që e përcakton veprën penale dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri V.M.

Sipas nenit 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dënueshmëria për këtë veprën penale sipas ligjvënësit është përcaktuar se me par.1. *“Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, ndërsa parag.2 parashihet që “Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”, ndërsa sipas dispozitës së nenit 318 par.1 të KPRK-së, parashihet që: “Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personit tjetër, e përvetëson pasurinë e cila i është besuar atij apo personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit”. Andaj, gjykata fillimisht ka shqiptuar dënim për secilën veprën penale veç e veç e me pas ka shqiptuar dënimin unik ka shqiptuar dënim me burgim prej 6 muajve si dhe dënim me gjobë në shumën prej 400 euro, sipas nenit 42 të KPRK-së. Përcaktimi i dënimit me burgim prej 6 muajve u bë duke marrë në vlerësim rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese të cekura si më lartë, gjykata ka shqiptuar dënimin si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përmes të cilit vlerëson se do të arrihet rehabilitimi i të pandehurit se dhe do të ndikoj në rehabilitimin dhe pengimi e të njëjtit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.*

Vendimin mbi llogaritjen e ndalimit e të akuzuarit për dyzetetë (48) orë në dënimin e shqiptuar me burgim, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast së i pandehuri dështon, refuzon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarës R.B nga Peja, me vendbanim në rrugën “.....” dhe të dëmtuares G.J.S, me vendbanim në rrugën “.....” nr..., në Pejë, në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform dispozitës së nenit 462 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par.1 dhe par. 2 dhe nenit 452 par. 1 të KPRK-së, e ngarkoi të pandehurin lidhur me për shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar prej fillimit të kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, në shumën prej 30 euro, në emër të paushallit gjyqësor e po ashtu konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej 20 euro, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilat obligohet ti paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.79/24, me datë 31.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KELMENDI

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.